

Konkluzione dhe rekomandime nga konferenca rajonale mbi *"Mbikëqyrjen parlamentare të politikave energjetike dhe investimeve në energji në Ballkanin Perëndimor"*.

Gjatë diskutimeve në konferencën rajonale në Budva, Mali i Zi, më 6 dhe 7 shtator, ishin diskutuar disa pika kryesore nga deputetët dhe ekspertët në fushën e energjisë nga Ballkani Perëndimor.

- A. Parlamentet kanë rol të kufizuar në mbikëqyrjen e investimeve në sektorin e energjisë dhe mbikëqyrjen e politikave energjetike dhe ka nevojë për angazhim më të madh të parlamenteve të Ballkanit Perëndimor për këtë çështje.
- B. Kapacitetet administrative dhe financiare të vendeve individuale të Ballkanit Perëndimor në tërheqjen e investimeve në energji janë të kufizuar; andaj, qasja e përbashkët rajonale për investime në energji është mënyra më e mirë e ecjes përpara për zhvillimin e ardhshëm të sektorit energjetik në Ballkanin Perëndimor.
- C. Vonesat në zbatimin e ligjeve të energjisë që rrjedhin nga traktati i komunitetit të energjisë janë të dukshme dhe duhet një bashkëpunim i përbashkët me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për monitorim të zbatimit.

Konkluzione dhe rekomandime nga Rrjeti i Komisioneve Parlamentare për Ekonomi, Financë dhe Integrim Evropian në Ballkanin Perëndimor

- 1. Rrjeti e njeh rëndësinë e investimeve të ardhshme në sektorin energjetik për zhvillimin e gjitha vendeve të rajonit dhe Parlamentet e Ballkanit Perëndimor kanë rol crucial në promovimin e themelimit të një tregu të përbashkët energjetik dhe të mbështesin projekte investuese në sektorin energjetik.
- 2. Parlamentet janë të inkurajuar të angazhojnë komunitetin akademik, afarist, investitorët dhe shoqërinë civile dhe aktorët tjerë jo-shtetëror në mbikëqyrjen e politikave të energjisë me anë të kyçjes së tyre në punën e komisioneve relevante parlamentare.
- 3. Rrjeti inkurajon parlamentet e rajonit të angazhohen në të ardhmen gjatë diskutimeve të dokumenteve energjetike. Strategjitë rajonale duhet të jenë në përputhje me strategjitë kombëtare të vendeve të Ballkanit Perëndimor.
- 4. Rrjeti inkurajon parlamentet dhe komisionet parlamentare të zhvillojnë një kulturë të mbikëqyrjes me anë të seancave të rregullta vjetore për zbatimin e ligjeve që janë të miratuar si pjesë e obligimeve që dalim nga Traktati i Komunitetit të Energjisë, në bashkëpunim me autoritetet e rregullimit të vendeve përkatëse.
- 5. Rrjeti duhet të ndërmerr aktivitetin e zhvillimit të pakove dhe veglave për trajnim dhe të bëjë përpjekje për pajisjen e deputetëve dhe stafin e parlamentit me njohurinë dhe veglat e nevojshme për të mbështetur mbikëqyrjen e politikave të energjisë.

Në fund, ishte theksuar që



NPC

Network of Parliamentary Committees
on Economy Finance and European
integration of Western Balkans



WESTMINSTER
FOUNDATION FOR
DEMOCRACY

Rrjeti rekomandon dhe mbështet themelimin e Asamblesë Parlamente të Komunitetit të Energjisë, e cila do të bashkojë anëtarët e Parlamentit Evropian dhe anëtarët e parlamenteve që janë pale kontraktuese të Traktatit.